

**PROCESVERBAL PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Rrethimi dekorativ i stadium te lojrave me dore ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Rrethrotullime per parqe lojrash 37535230-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 335 385 lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/ç dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tropoje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SHTOJCA 7

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet 2020 dhe 2021, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros minimale në të paktën një vit, duhet të jetë jo më e vogël se 20% te vleres se perlllogaritur te fondit limit
2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të pasqyrave financiare të viteve 2020 dhe 2021, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet. Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2020,2021 duhet të jenë të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar, kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 41, të ligjit nr. 10091 date 05.03.1999. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).

(Taksat vendore 2022,vertetim energjie ,vertetim detyrimesh ,kontributeve sipas shtojces nr.8)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 43, të

2.2. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të ketë:
 - i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

-Si dëshmi për përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore (të jenë të deklaruara në organet tatimore) dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5, si dhe nenin 77 të LPP.

2 Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencë profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të kategorive dhe niveleve si më poshtë:

- Kategoria NP- 2 A Ndertime civile dhe industriale”.
- Kategoria NS- 1 A Punime për prishjen e ndertimeve ”.
- Kategoria NS- 4 A Punime rifiniture të muratues dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6, a, si dhe nenin 77 të LPP.

Nivelet dhe kategoritë e licencës janë bazuar në VKM 943 datë 28.12.2016 dhe në Vendimin nr. datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtarinë ndërtimi”.

Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi A (edhe për herë të parë) 0 - 20 milion lekë.

3. Operatorët ekonomik ofertues, për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt duhet të ketë të punësuar si staf teknik në licencën (drejtuesë teknikë),

-1(një) Drejtues Teknik ,

Ne zbatim te pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”,nenit 26 pika 2/h si dhe përcaktimet e pikës 6, te nenit 26 te VKM-se, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6, c, si dhe nenin 77 të LPP.*

Ing. Ndërtimi është përcaktuar pasi rikonstruksioni ka të bëjë me punime ndërtimore prej betoni

Ing. Elektrik është përcaktuar pasi do të ketë ndërhyrje në punimet elektrike të ambienteve.

Argumentimi që drejtuesi teknik të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë të paktë 3 Muaj nga data e hapjes së tenderit, është gjykuar nga AK, për tu siguruar që operatorët ekonomik kanë një konsolidim ose qëndrueshmëri të stafit, për arsye të besueshmërisë në realizimin me sukses të kontratës.

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik si më poshtë:

- | | | |
|--|--------|--------------------------|
| 1. Kamion vetshkarkues jo me pak se 12 ton | 1 cope | (Ne pronesi ose me qera) |
| 2. Kamion me vinc | 1 cope | (Ne pronesi ose me qera) |
| 3. Minieskavator | 1 copë | (Ne pronesi ose me qera) |
| 4. Matrapik | 1 copë | (Ne pronesi ose me qera) |
| 5. Betoniere | 1 cope | (Ne pronesi ose me qera) |
| 6. Vibrator betoni | 1 cope | (Ne pronesi ose me qera) |
| 7. Depozit uji | 1 cope | (Ne pronesi ose me qera) |
| 8. Gjenerator | 1 cope | (Ne pronesi ose me qera) |

-Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe/ose faturat tatimore, ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqiten kontrata e qirasë, faturat tatimore dhe kontrata e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit më sipër (për rastet e faturave të biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.

-Për automjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, vërtetimi i pagesës për taksat vjetore, siguracioni dhe fotot përkatëse, ndërsa për automjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

-Për automjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për automjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: Makineritë dhe pajisjet e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e sakte të mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi.

Ne zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,nenit 26 pika 2/i si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26 të VKM-se, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6, d, si dhe nenin 77 të LPP. Mjetet e pajisjet teknike të mësipërme, janë të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, përputhje me volumin e punimeve.*

1. Operatori Ekonomik duhet të ketë Certifikatën e vlefshme ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga institucione zyrtare të akredituar për këtë qëllim, ose ekuivalente me të.
2. Operatori Ekonomik duhet të ketë Certifikatën e vlefshme ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit”, lëshuar nga institucione zyrtare të akredituar për këtë qëllim, ose ekuivalente me të.

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 44 “Kërkesa e cilësisë” pika 1, 3, si dhe nenin 77 të LPP. Certifikatat kërkuara më sipër janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke mbajtur në konsideratë parimin e mosdiskriminimit.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/ç dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tropoje , me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. ____ prot. ____ datë __.__.2022, ka ngritur grupin e punës si dhe Urdherin nr. ____ prot. ____ date __.__.2022, te cilet kan kryer:

- Hartimin e specifikimeve teknike;
- Përlllogaritjen e fondit limit;
- Hartimin e Kriteve të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik;
- Hartimin e kriteve të vlerësimit;
- Përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafikun e livrimit).

Njësia e Prokurimi